

LAJMET E RREME

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Si mund t'i dallojmë lajmet e rreme?

Ka shumë lajme të rreme rreth koronavirusit, që qarkullojnë në mediet sociale, sidomos për kurat e rreme. Ndonjëherë, nxënësit i ndajnë me njëri-tjetrin këto lajme, pa qenë kritikë ndaj tyre, duke menduar se janë të vërteta ose thjesht argëtuese. Ky mësim trajton pasojat e qarkullimit të lajmeve të rreme dhe mënyrën se si të dallojmë lajmet e vërteta nga ato të rreme.

Nxënësit do të jenë të aftë:

- ▶ Të reflektojnë mbi pasojat e qarkullimit të lajmeve të rreme;
- ▶ Të analizojnë lloje të ndryshme lajmesh të rreme;
- ▶ Të identifikojnë teknikat për dallimin e lajmeve të rreme;
- ▶ Të zhvillojnë të menduarin analitik dhe kritik, si dhe ndjesinë e përgjegjësive digjitale.

**Aftësitë
e njohjes së medias
dhe të informacionit**

STIMUL

Kuiz: E vërtetë/E gabuar

<https://fullfact.org/quiz/coronavirus/>

Artikull/lajm: <https://bit.ly/34lch8Z>

Mund t'ju duhet të gjeni një *kuiz* të ngjashëm në gjuhën shqipe ose të krijoni vetë një *kuiz* – por kujdesuni që të dhënat të jenë të përditësuara.

A ka lajme/artikuj të ngjashëm në shqip?

DISKUTIM

Pas kuiz-it:

- ▶ Si dole në kuiz? A të befaso i ndonjë përgjigje? Nëse po, cila? Pse?
- ▶ Pse qarkullojnë lajme të pavërteta për koronavirusin në mediet sociale?
- ▶ A shkaktojnë ato ndonjë dëm? Po/ Jo. Pse?

Pas artikullit/lajmit:

- ▶ Pse i besojnë njerëzit kurat e rreme si kjo?
- ▶ A dini ndonjë lajm tjetër të rremë rreth koronavirusit?
- ▶ Si mund ta verifikoni nëse një lajm/artikull është apo jo i rremë?
- ▶ Ku mund të drejtoheni për ndihmë?

Nëse nxënësit nuk besojnë se një lajm është i rremë, tregoni kujdes në trajtimin e çështjes.

Tregojuni nxënësve për faqe interneti serioze ose zyrtare, si p.sh. faja e OBSH-së dedikuar Coronavirus.

PËRFUNDIM

Përmbledhni pikat kryesore të mësimin.

Kujtojuni nxënësve se sa e rëndësishme është të verifikojnë lajmet e të tregojnë kujdes para se t'i qarkullojnë ato.

Praktikoni mënyrat kryesore të verifikimit të lajmeve të rreme.

Më pas, kërkojuni nxënësve që të bëjnë një përmbledhje.

DETYRË

Nxënësit zhvillojnë aftësitë e verifikimit të lajmeve të rreme.

Video: <https://newsliteracy.ca/fakeout/learning-the-skills/>

Në grupe të vogla, nxënësit zgjedhin tri ose katër lajme mbi koronavirusin dhe verifikojnë besueshmërinë e tyre.

Ata përgatisin disa këshilla për bashkëmoshatarët për këtë çështje dhe bëjnë një prezantim.

Ka shumë video mbi këtë temë në internet.

Nxitini nxënësit që të përdorin forma risore të prezantimit digjital, duke i bërë ato sa më tërheqëse për bashkëmoshatarët e tyre.

VIJIM

Nxënësit paraqesin pikat kryesore që kanë mësuar nga kjo detyrë. Ata shpjegojnë këshillat që do t'u jepnin bashkëmoshatarëve për këtë çështje.

Nxënësit diskutojnë për përgjegjësitë shoqërore të personave që shpërndajnë *online* lajme të rreme.

Nxënësve mund t'u jepet për të verifikuar ndonjë lajm tjetër, që mund të jetë i rremë.